

KARTËMONEDHA 10000 LEKË KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

PSE NJË SERI E RE?

Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është të garantojë besimin e publikut në paranë tonë kombëtare. Ajo e bën këtë duke emetuar një kartëmonedhë që i komunikon publikut shqiptar siguri dhe qëndrueshmëri. Mbi 20 vjet pas hedhjes në qarkullim të serisë së vjetër të kartëmonedhave Lek, natyrshëm kishte lindur nevoja e përmirësimit me elemente të reja sigurie, për t'i bërë ato më të sigurta ndaj falsifikimit. Kartëmonedhat tona shërbejnë edhe si mbartëse të identitetit kombëtar. Përmes mjeshtrisë artistike, ato promovojnë historinë e Shqipërisë dhe theksojnë kontributet e personaliteteve të saj.

Për këto arsye, nga viti 2019, Banka e Shqipërisë filloi emetimin e një serie të re të kartëmonedhave Lek, me pamje të rifreskuar dhe elemente sigurie të përmirësuara. Kjo seri është prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës, duke u kujdesur njëkohësisht që edhe pamja e kartëmonedhave të jetë më moderne.

PREZANTIMI GRADUAL I SERISË VAZHDON

Kartëmonedha 10000 Lekë emetohet dhe hidhet për herë të parë në qarkullim, duke pasuruar kështu serinë e kartëmonedhave të reja me një prerje tërësisht të re, në përputhje me nevojat e ekonomisë shqiptare.

Shtypja dhe hedhja në qarkullim e kësaj kartëmonedhe, me prerjen më të lartë 10000 Lekë, përfaqëson në vetvete përshtatjen e strukturës së kartëmonedhave me strukturën e çmimeve dhe pagave, zhvillimet e sistemit të pagesave, si dhe tregues të tjerë që lidhen me trajtimin e parasë.

Seria e kartëmonedhave shqiptare tashmë do të ketë këto prerje: 200, 500, 1000, 2000, 5000 dhe 10000 Lekë.

KËSHILLA PËR PËRDORIMIN E KARTËMONEDHAVE

Kartëmonedha përbën një vlerë kombëtare.

Trajtoje kartëmonedhën ashtu siç është: më shumë se një letër me vlerë. Përveçse mbart vlerën nominale, ajo paraqet një ndërthurje të vlerave artistike me elemente të identitetit kombëtar.

Ruaje kartëmonedhën në portofol.

Mos e dëmto duke e rrudhosur, përthyer, shkruar, ngjyrosur, prerë, ngjitur ose lagur atë. Kështu, ti ndihmon që ajo të qëndrojë në qarkullim, sa më gjatë.

DHE MOS HARRO!!!

Lexo dhe përdor shifrën që shkruhet mbi kartëmonedhë! Mos i shto një 0! Mos e quaj as lek i vjetër, as lek i ri! Ai është thjesht LEK. Kërkoju edhe të tjerëve ta respektojnë atë, njësoj si ti.

10000

BANKA E SHQIPËRISË



A
A
O
O
O
O
O
O
O

0
0
0
0
0
0
0
0

GUVERNATORI DREKTORI

ELEMENTET E SIGURISË

Kontrollo nëse kartëmonedha është e vërtetë, përmes verifikimit të elementeve të sigurisë me metodën “PREK, SHIKO, LËVIZ”.

PREK

Preke dhe ndieje kartëmonedhën me gishta.

Letra e kartëmonedhës është prodhuar nga pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim dhe konsistencë e veçantë.

- 1 Shtypi i ngritur.** Ndieje shtypin e ngritur në të dy faqet e kartëmonedhës, te vlera nominale, tekstet, portreti, flamuri dhe gramafoni. Ndiej vijat e shkurtra përgjatë anës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë elementin e njohjes nga personat me aftësi të kufizuara shikimi.

SHIKO

Mbaje kartëmonedhën kundrejt dritës dhe shikoje me kujdes.

- 2 Figurat ujore.** Portreti i kartëmonedhës, vlera nominale e saj dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme.
- 3 Filli i sigurisë.** Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë duket një vijë e errët dhe e pandërprerë. Në të dallohen vlera nominale 10000 Lekë dhe penda e stilizuar.

LËVIZ

Lëvize kartëmonedhën në kënde të ndryshme shikimi, për të parë si ndryshon.

- 4 Holograma,** shiriti i argjendtë në të majtë, shfaq në radhë logon e Bankës së Shqipërisë, portretin e Asdrenit, vlerën nominale 10000 Lekë dhe librin me pendë, të shoqëruar me efekte të ndryshme optike.
- 5 Figura me ngjyrë të ndryshueshme.** Libri me pendë në këndin e sipërm djathtas ndryshon ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, e shoqëruar me një efekt dinamik të figurës majtas e djathtas.
- 6 Filli i sigurisë** ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt.
- 7** Në faqen e pasme të kartëmonedhës, **shiriti i shndritshëm** në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 10000 Lekë.

